



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



RAPORT MONITORUES PËR KOSTT

**INVESTIMET KAPITALE-SHPENZIMET OPERATIVE DHE PËRFORMANCA PËR
PERIUDHËN 2013-2015**



Dhjetor 2016

Përmbajtja:

1. HYRJE.....	4
1.1 Përmbledhje ekzekutive.....	4
1.1 Sektori i rregulluar – metodologjia.....	5
2. Monitorimi i investimeve kapitale dhe shpenzimeve operative të KOSTT.....	6
2.1 Investimet Kapitale	6
2.2 Ndikimi i investimeve kapitale në parametrat e performancës	8
2.3 Kostot operative dhe të mirëmbajtjes	11
2.4 Të dhënat energjetike dhe financiare 2013-2015.....	11
2.5 Piku maksimal - profili i ngarkesës	12
2.6 Humbjet në nivelin e transmisionit.....	13
2.7 Shërbimet ndihmëse dhe Mekanizmi i ITC	13



Shkurtesat:

BRE	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
CAPEX	Capital Expenditures (Shpenzimet kapitale)
FP	Furnizuesi Publik
GWh	Gigavatorë
HC	Hidrocentral
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KEDS	Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike
KOSTT	Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut
kV	Kilovolt
kW	Kilovat
LP	Largpërçues
MAR	Të Hyrat Maksimale të Lejuara (HML)
MW	Megavat
MWh	Megavatorë
NS	Nënstacioni
OPEX	Operational Expenditures (Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes)
OSSH	Operator i Sistemit të Shpërndarjes
OST	Operator i Sistemit të Transmisionit
OT	Operator Tregu
RoR	Rate of Return (Norma e kthimit)
RAB	Regulated Asset Base (Baza e Rregulluar e Aseteve)
SCADA	Supervisory Control and Data Acquisition (Sistemi Mbikëqyrës dhe i Mbledhjes së të Dhënave)
Sh.A	Shoqëri aksionare
TC	Termocentral
TL	Tensioni i lartë
TR	Transformator
TM	Tensioni i Mesëm
TU	Tensioni i Ulët
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji



1. HYRJE

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), në pajtim me kompetencat dhe obligimet e përkufizuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe në Rregullën për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë ka ndërmarr monitorimin e ndërmarrjeve të licencuara energjetike në Kosovë për periudhën raportuese 2013-2015. Në harmoni me këto ligje ZRRE ka themeluar grupe punuese për monitorimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të tilla. Një ndër këto grupe është edhe grupi punues për monitorim e investimeve kapitale, shpenzimeve operative dhe indikatorëve të tjerë të performances të të licencuarve KEK, KOSTT, KEDS dhe KESCO.

Stafi i ZRRE-së, gjatë muajit shtator 2016 ka mbajtur takime me menaxhmentin e KEK-ut, KEDS/KESCO dhe të KOSTT-it lidhur me investimet kapitale të implementuara në sektorin e energjisë, shpenzimet operative të realizuara si dhe performancën e ndërmarrjeve në sektor. Me qëllim të shmangies së paqartësive eventuale të të dhënave dhe të gjeturave të prezantuara në këtë raport, ZRRE paraprakisht e ka dërguar në KOSTT draftin fillestar për komentim.

1.1 Përmbledhje ekzekutive

Raporti përmban informata dhe të dhëna të raportuara nga të licencuarit për periudhën 2013-2015, konstatime që dalin nga procesi i monitorimit në sferën e investimeve kapitale, shpenzimeve operative dhe indikatorët tjerë të performances. Pas të gjitha analizave, grupi punues i këtij raporti, ka paraqitur të gjeturat kryesore rreth investimeve kapitale dhe shpenzimeve operative të KOSTT. Ky raport do të shqyrtohet në detaje gjatë shqyrtimit periodik të rregullt tarifor.

Të gjeturat kryesore për shqyrtim nga Bordi i ZRRE-së, janë si në vijim:

- KOSTT përgjatë kësaj periudhe nuk ka realizuar investimet kapitale të planifikuara sipas dinamikës së lejuar nga ZRRE për periudhën rregullative.
- Gjatë analizimit të të dhënave të KOSTT, ZRRE ka marrë parasysh faktorin e efikasitetit prej 4% në shpenzimet operative, për periudhën 2013-2015 ato janë tejkualuar për 6 % krahasuar me nivelin e lejuar. Shpenzimet e mirëmbajtjes nuk janë realizuar në nivelin e lejuar, duke ditur që kjo ndikon në përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve për konsumatorët, kjo konsiderohet shqetësuese për ZRRE-në.
- Gjatë analizimit të të dhënave, shqetësim i ZRRE-së është se KOSTT, që nga fillimi i periudhës rregullative është duke i tejkualuar shpenzimet e lejuara për paga, duke shfrytëzuar mjete të lejuara nga zëra tjerë shpenzues.



1.2 Sektori i rregulluar - metodologjia

Ne sektorët e rregulluar, te hyrat e lejuara maksimale përcaktohen nga rregullatori ashtu që të licencuarit ti mbulojnë kostot e tyre të arsyeshme për ofrimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve. Ngarkesat (çmimet) dizajnohen ashtu që të mbulojnë kostot për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Ne kuadër të të hyrave të lejuara janë edhe kostot që kanë të bëjnë me investimet kapitale. Metodologjia në bazë të cilës njihen kostot e të licencuarve përmbajnë elemente të performancës ashtu që secili operator nxitet të bëjë investimet e duhura duke i mundur kthim të arsyeshëm për investimet e bëra.



Figura 1-RoR (Kthimi i rregulluar)

Norma e kthimit (WACC) aprovohet nga rregullatori dhe aplikohet më pastaj ndaj vlerës së investimeve kapitale (CAPEX-it) për të kalkuluar kthimin e lejuar.

Duke qenë ky sektorë të rregulluar, rregullatori i energjisë siguron që interesat e kompanisë dhe konsumatorëve të jenë të balancuara. Norma e kthimit për investime aprovohet nga rregullatori për periudhë rregullative (4-5 vite) dhe ajo garanton që operatori të sigurojë fitim të rregulluar të arsyeshëm dhe konsumatorët të përfitojnë në kualitetin e shërbimit.

Me poshtë është paraqitur figurativisht nxitja e investimeve përmes normës së kthimit dhe balancimi i interesave ndërmjet kompanisë dhe konsumatorëve nëpërmjet rregullimit.



Figura 2-Rregullimi



2. Monitorimi i investimeve kapitale dhe shpenzimeve operative të KOSTT

Në bazë të Licences për Operatorin e Sistemit të Transmisionit (OST) , OST duhet të hartojë dhe publikojë Planin Zhvillimor Investiv afatmesëm të dalë nga Plani Zhvillimor Afatëgjatë (10 vjeçar) i Sistemit të Transmisionit. Po ashtu në Rregullin për Vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut, janë të specifikuarat kërkesat për hartimin e Planit Investiv.

Plani i aprovuar i investimit përfshinë: projektet kapitale të cilat janë të nevojshme për të ofruar shërbimet e sistemit të transmisionit dhe operatorit të tregut; identifikojë çdo projekt kapital të renditur sipas prioritetit; tregojë përfitimin nga performanca e rrjetit që pritet të arrijë çdo projekt kapital, duke i'u referuar, përmbushjes së standardeve të caktuara për sigurinë e sistemit të transmisionit, standardeve të sigurisë së operimit apo planifikimit.

2.1 Investimet Kapitale

Lidhur me monitorimin e investimeve kapitale, KOSTT ka ofruar të dhënat e kostove kapitale të realizuara gjatë periudhës 2013-2015, ku përfshihen të gjitha projektet në proces dhe të përfunduara brenda periudhës së raportuar.

Duke krahasuar vlerat e realizuara ndaj atyre të lejuara për periudhën përkatëse, vërejmë se KOSTT-i ka realizuar 19.7 mil€ të investimeve kapitale nga 35.5 mil€ në vitin 2013, e shprehur në përqindje 56%, ka realizuar 11.8 mil€ të investimeve kapitale nga 31.2 mil€ në vitin 2014, e shprehur në përqindje 38% dhe ka realizuar 29.7 mil€ të investimeve kapitale nga 26.9 mil€ në vitin 2015, e shprehur në përqindje 110 %.

Vlen të theksohet se për periudhën 2013-2015 janë lejuar rreth 94 mil€, ndërsa janë realizuar 61 mil€ apo janë realizuar investimet kapitale në normen prej 65%. Nga vlera e investuar me financim vetanak janë prezantuar 43.3 mil€, apo 70% dhe pjesa tjetër janë investime nga grantet.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur lista e projekteve kapitale në KOSTT për periudhën 2013-2015.

Emrat e projekteve	2013		2014		2015	
	Lejuar (€'000)	Aktual (€'000)	Lejuar (€'000)	Aktual (€'000)	Lejuar (€'000)	Aktual (€'000)
LP 400 kV, Kosove - Shqiperi me shërbimet konsulente	5,000	101	9000	7,431	8,500	20,828
Kycja e NS Lipjanit në linjën 110kV LP 112	181	666	-	-	-	-
Ndërrimi i përcuesve dhe izolatorëve dhe pajisjeve lidhëse në linjat 110kV LP 125/2 dhe 125/3	431	320	-	-	-	-
Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS 110/35kV Ferizaji 1 dhe NS Gjilani 110/35(10) kV	280	301	-	24	-	-
Rialokimi i linjës 110kV, nr 1806 , NS 110/35kV Gjakova 1 - Ns 110/10kV Gjakova 2 & Ndërrimi i pajisjeve të TL 110kV në Gjakova 1	1,409	1,144	-	425	-	138
Rehabilitimi i stabilimenteve te TL ne NS 110/10 kV - Gjakova 2	815	393	996	752	-	271
Rehabilitimi i stabilimenteve te TL ne NS 110/10 kV - Prizreni 3	815	442	996	598	-	185
Ndërrimi i pajisjeve te TL ana 400KV ne TS KOS B	44	31	-	-	-	-
Furnizim me transformator te fuqise	418	396	-	-	-	-
Paket projekti NS 110/10(20) Gjilani 5 me linjat transmetuese	7,100	4,865	-	-	-	-
Paket projekti NS 110/10(20)Palaj me linjat transmetuese	5,086	5,287	-	-	-	-
Paket projekti NS 110/10(20) Prishtina 7 5 me linjat transmetuese	3,362	3,770	-	-	-	-
LOT 1 =Nënstacionet Kredi / Grant (Vlera e Projektit 8530 mil Euro pa dogana)	150	-	6,500	-	6,350	-
LOT 2 - Transformatorët /Grant IPA dhe Kfw	75	-	1,238	-	937	-
LOT 3 - Linjat transmetuese GRANT /KREDI /Shpenzime vetanake (Vlera Totale 8500 mil Euro pa dogana)	75	-	1,238	-	938	-
LOT 4 - Projekte shtese -(Vlera Totale 9800mil euro pa dogana)	231	-	6,171	-	7,098	-
Shërbimet konsulente për projektet e KfW - GRANT (Vlera Totale 1573 mil euro)	1,573	-	-	411	-	370
Instalimi i Transfprimatorit TR2 në NS 110/10(20) kV Skenderaj	603	-	259	550	-	354
Furnizim me nderpreres te fuqise te tensionit 10 kV	16	-	-	-	-	-
Furnizim me pajisje per komplet fushen (ana 35 kV)	127	-	-	-	-	-
Instalimi i Transfprimatorit TR2 në NS 110/10 kV Klinë	-	-	-	-	-	-
Revitalizimi i NS 110kV ana 35 kV * NS Gjakova 1	172	-	172	198	172	123
Furnizimi dhe instalimi i mbrojtjeve rele numerike ne fushat autotransformatorike Në NS KOS B , NS KOS A dhe NS PZ 2	86	-	-	50	-	60
Ndërtimi i NS 110/10(20)kV Mitrovica 2 me linjat përcjellse	-	-	-	-	948	-
Ndërtimi i NS 110/10(20)kV Dragashi dhe linja 110kV NS Kukës-NS Dragash- NS Prizren 2	-	-	-	-	1,379	-
Instalimi i grupeve matëse në kufirin e ri mes KOSTT dhe KEK/OSSH	1,043	-	853	-	-	971
Furnizimi me transformatorë te fuqisë te tensionit 10/0.4kV	15	-	7	-	15	-
Furnizimi me bobina te petersenit dhe reaktanca për transformatorët e fuqisë	60	-	60	-	30	-
Shpronësimi i Tokave	86	-	86	49	86	569
Infrastruktura Tjeter	1,612	1,265	603	1,052	-	-
Furnizimi me makineri	617	521	-	69	-	-
Hardwer (PC , printer , tonere , aksesore)	147	100	34	92	17	19
SCADA/EMS & Telekom	93	65	93	16	-	91
Rregullimi sekondar Kosove - Shqiperi	3,000	-	2,500	-	-	4,540
Përfshirja e të gjitha ndryshimeve në nënstationet ekzistuese si dhe inkorporimi i nënstationeve të reja në SCADA/EMS në Qendrën Dispeçerike dhe në Qendrën Emergjente Dispeçerike	651	-	431	-	431	1,146
Hardwer (PC , printer , tonere , aksesore)	147	100	34	92	17	19
Gjithsej	35,520	19,767	31,273	11,809	26,920	29,684

Tabela 1- CAPEX-it i lejuar dhe realizuar KOSTT

Duhet të përmendet se ndikim në mos realizimin e investimeve kapitale kanë disa faktorë, të cilët janë jashtë kontrollit të KOSTT, siç janë: procedurat e prokurimit të KOSTT-it, procedurat e prokurimit të KfW dhe të BERZH-it, procedurat e marrjes së lejeve ndërtimore, procesi i shpronësimit të tokave dhe servitutit dhe procesi i vlerësimit për to nga MPHM.

KOSTT ka arritur që vitin 2015 ta përmirësojë trendin e investimeve ku janë realizuar më shumë investime se sa janë planifikuar, dhe presim që ky trend do të vazhdojë edhe me tutje të jetë në ngritje, ashtu që niveli i realizuar i investimeve të jetë në pajtueshmëri me nivelin e lejuar nga ZRRE.

2.2 Ndikimi i investimeve kapitale në parametrat e përformancës

Në vijim janë paraqitur përshkrimet teknike të projekteve madhore, arsyeshmëria e projekteve, ndikimi në performancën e sistemit, objektivat dhe benefitet që arrihen me realizimin e investimeve kapitale .

Linja 400kV interkonektive Kosovë–Shqipëri; si përfitime kryesore janë ngritja e kapacitetit të interkoneksionit për 1330 MVA, respektivisht ngritja e kapacitetit NTc për 500MW, ngritja e sigurisë së sistemit dhe integrimet për dy vendet në tregun regjional (uljen e kostove për dy vendet dhe shërbimeve rregulluese), krijon kushte për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, krijon të hyra nga mekanizmi I ITC, ngriti margjinën e stabilitetit dinamik të dy vendeve etj.

Kyçja e NS Lipjanit në linjën 110kV LP 112; përfitimet nga investimi në këtë projekt janë: plotësimi i kriterit të sigurisë së furnizimit për konsumin e Lipjanit, duke përfshirë aeroportin e Prishtinës, krijimi i konfiguracionit unazor 110 kV që krijon rrjet fleksibil për operim të rrjedhave të fuqisë, ngritja e kapaciteteve të transmisionit dhe reduktimi i humbjeve të fuqisë, përmirësim i kualitetit të furnizimit të konsumit të Lipjanit me rrethinë, mundëson përkrahjen e rritjes së konsumit industrial etj.

Ndrrimi i përçuesëve dhe izilatorëve dhe paisjeve lidhëse në linjat 110 kV LP125/2 dhe 125/3- përfitimet nga investimet janë: përforcimi i rrjetit dhe reduktimi i humbjeve, ngritja e kapaciteteve të linjave nga 83 MVA në 114 MVA, plotësimi i kriterit N-1 në raste të rënies së linjave tjera 110 kV, përcjellja e zhvillimit të ngarkesës konform kërkesave që dalin nga Kodi i Rrjetit, ngritja e sigurisë së operimit të rrjetit transmetues etj.

Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS 110/35 kV Ferizaji 1 dhe NS Gjilani 110/35 (10)kV, NS 110/10 kV - Gjakova 2 dhe NS Prizreni 3; investimet në këto projekte janë kryer për shkak të përfundimit të ciklit jetësor të paisjeve/vjetërsia, frekuenca e ngritur e prishjeve. Si përfitime kryesore nga investimi janë: ngritja e sigurisë së operimit të nënstacioneve në fjalë, reduktimi i ndërprerjeve të pa-planifikuara respektivisht energjisë së pa dërguar etj.

Rialokimi i linjës 110kV, nr 1806 , NS 110/35kV Gjakova 1 - Ns 110/10kV Gjakova 2 & Ndërrimi i paisjeve të TL 110kV në Gjakova 1; realizimi i këtij projekti ka bërë të mundur plotësimin e kriterit



N-1, për unazën 110 kV të lartpërmendur në domen kohor afatgjatë dhe si i tillë do të reduktoj për dy numrin e elementeve të rrjetit të cilat nuk plotësojnë kriterin N-1, procesi i mirëmbajtjes së linjave tani është më lehtë i realizueshëm, janë ngritur kapacitetet e rrjetit dhe është mundësuar puna e ndarjes në grupe të rrjetit 110 kV, është ngritur siguria e operimit e asaj të rrjetit, është zvogëluar numri i orëve të ndërprerjeve të pa-planifikuara si dhe energjisë së padërguar te konsumi, është ngritur siguria e operimit të NS Gjakova 1, i cili paraprakisht karakterizohej me pajisje shumë të vjetra dhe me risk të lartë të operimit etj.

Paket projektet NS 110/10(20) Gjilani 5 me linjat transmetuese, projekti NS 110/10(20)Palaj, NS 110/10(20) Prishtina7- përfitimet nga investimet janë: përkrahje e ngarkesës së Gjilanit duke suportuar zhvillimin e ngarkesës, krijimi i konfiguracionit të ri të rrjetit 110 kV me rezerva të mjaftueshme operuese, reduktim i humbjeve dhe përmirësim i kualitetit të furnizimit, ngritja e sigurisë së furnizimit të minierës së linjës, reduktim i energjisë së padërguar te konsumi etj.

Instalimi i autotransformatorit të dytë ATR2, 300 MVA në NS 400/110kV Peja 3 dhe NS 400/110 kV Ferizaj2, Instalimi i transformatorit TR2 në NS 110/10 kV në komunat e Skenderaj dhe Klinë- përfitimet nga investimet janë: plotësimi i kriterit N-1, ngritja e sigurisë së furnizimit të konsumit, optimizim i procesit të mirëmbajtjes së transformatorëve, reduktim i orëve të ndërprerjeve të paplanifikuara, respektivisht të energjisë së padërguar te konsumi, përforcim i transformimit 400/110 kV etj.

Linja e re 110 kV NS Peja 3- NS 110/35 kV Peja 1 dhe ri-vitalizimi i NS Peja 1, Ri-vitalizimi i linjës 110 kV: L126/2 NS Peja 2- NS Deçan & ndërrimi i ndërprerësve në NS Prishtina 4; përfitimet nga investimet janë: plotësimi i kriterit N-1 sa i përket linjave 110 kV, reduktim i humbjeve në linjat 110 kV, përmirësim i nivelit të tensioneve në NS Peja 1, 2 dhe NS Deçani, mirëmbajtje më optimale e linjave në rajonin e Dukagjinit, ngritja e kapacitetit të linjave 110 kV për $114+(114-83)=145\text{MVA}$, ngritja e sigurisë së operimit të NS Prishtina 4, përmes ndërrimit të ndërprerësve të fuqisë me ndërprerësa SF6 me fuqi më të lartë të shkyçjes së lidhjeve të shkurta etj.

Në tabelën në vijim janë dhënë edhe parametrat kuantitativ se si kanë ndikuar investimet kapitale të realizuara në reduktimin e humbjeve, zvogëlimin e ndërprerjeve, përmirësimin e tensionit, numrin e konsumatorëve përfitues, numri i nënstacioneve, numri i trafove dhe gjatësia e rrjetit ajror të realizuar.

Emrat e projekteve	Pershkrimi i ndikimit te investimeve pas realizimit						Numri i konsumatoreve perfitues
	Reduktimi i humbjeve %	Reduktimi i humbjeve MWh	Zvoglimi linderprerjeve h (ore)	Zvoglimi i nderprerjeve %	Permirsimi i tensionit %	Ndikimi ne reduktimin e kostove operative	
LP 400 kV, Kosove - Shqiperi me shërbimet konsulente	-	-	-	-	-	-	1,800,000
Kycja e NS Lipjanit në linjën 110kV LP 112	0	1,000	0	0	0	-	70,000
Ndërrimi i përcuesve dhe izolatorëve dhe pajisjeve lidhëse në linjat 110kV LP 125/2 dhe 125/3	0	1,200	0	0	-	-	100,000
Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS 110/35kV Ferizaji 1 dhe NS Gjilani 110/35(10) kV	NA	NA	0	0	NA	-	120,000
Rialokimi i linjës 110kV, nr 1806 , NS 110/35kV Gjakova 1 - Ns 110/10kV Gjakova 2 & Ndërrimi i pajisjeve të TL 110kV në Gjakova 1	0	1,000	0	0	0	-	250,000
Rehabilitimi i stabilimenteve te TL ne NS 110/10 kV - Gjakova 2	NA	NA	0	0	NA	-	50,000
Rehabilitimi i stabilimenteve te TL ne NS 110/10 kV - Prizreni 3	NA	NA	1	0	NA	-	60,000
Ndërrimi I pajisjeve te TL ana 400KV ne TS KOS B	NA	NA	0	0	NA	-	1,800,000
Furnizim me transformator te fuqise	0	100	0	0	-	-	85,000
Paket projekti NS 110/10(20) Gjilani 5 me linjat transmetuese	0	2,100	0	0	0	-	75,000
Paket projekti NS 110/10(20)Palaj me linjat transmetuese	0	1,000	0	0	0	-	35,000
Paket projekti NS 110/10(20) Prishtina 7 5 me linjat transmetuese	0	1,000	1	0	-	-	45,000
Instalimi i autotransformatorit të dytë ATR2, 300 MVA në NS 400/110kV Peja 3 dhe NS 400/110 kV Ferizaji2 & Sherbimet konsulente (IPA 2011)	-	-	1	0	0	-	550,000
INTER - Njehsoret & Shërbimet konsulente	NA	NA	NA	NA	NA	-	1,800,000
Instalimi i OPGW ne linjat interkonektive 400 & 220kV & Sherbimet konsulente (IPA 2011) ,	NA	NA	NA	NA	NA	-	1,800,000
IPA 2012 , Grant : ECLLO 25,93% dhe Kredi : 74,07%	0	2,900	1	0	0	-	100,000
Instalimi I Transfprimatorit TR2 në NS 110/10(20) kV Skenderaj	0	100	0	0	-	-	55,000
Furnizim me nderpreres te fuqise te tensionit 10 kV	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Furnizim me pajisje per komplet fushen (ana 35 kV)	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Instalimi I Transfprimatorit TR2 në NS 110/10 kV Klinë	0	100	0	0	-	-	40,000
Revitalizimi I NS 110kV ana 35 kV	NA	NA	0	0	NA	-	350,000
Furnizimi dhe instalimi i mbrojtjeve rele numerike ne fushat autotransformatorike	NA	NA	0	0	NA	-	350,000
Ndërtimi I NS 110/10(20)kV Mitrovica 2 me linjat përcjellse	0	1,500	0	0	-	-	65,000
Ndertimi i NS 110/10(20)kV Dragashi dhe linja 110kV NS Kukës-NS Dragash-NS Prizren 2	0	1,500	0	0	-	-	35,000
Paket projekti NS 110/10(20) kV Malisheva me linjat transmetuese	0	2,000	1	0	-	-	45,000
Paket projekti NS 110/10(20) kV Fushe Kosove me linjat transmetuese	0	800	0	0	-	-	55,000
Paket Projekti i NS 110/10(20) kV-Prishtina 6 me linjat kabllloviqe nentokesore 110 kV	0	500	0	0	-	-	70,000
Instalimi i grupeve matëse në kufirin e ri mes KOSTT dhe KEK/OSSH	NA	NA	NA	NA	NA	-	1,800,000

Tabela 21-Ndikim i investimeve kapitale KOSTT

2.3 Kostot operative dhe të mirëmbajtjes

Ngjashëm si për kostot kapitale, ashtu edhe për kostot operative kemi pranuar të dhëna dhe sqarime nga KOSTT për shpenzimet operative për periudhën 2013-2015.

KOSTT Sh.A, i janë lejuar për këtë periudhë shpenzime operative në vlerë prej 21.2 mil€, ndërsa ka realizuar në vlerë prej 22.4 mil€, ku ka tejkaluar shpenzimet operative për 6 %.

Në shpenzimet tjera operative përfshihen: vajrat dhe lubrifikantet, udhëtimet zyrtare, sigurimi fizik, materialet, inventari i imët, komunalitet, konsultimet, marketingu, reprezentacion, tatimi në pronë, shërbimet shëndetësore, sigurimi i veturave, shpenzimet bankare, shpenzimet e anëtarësimeve trajnimet etj.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet operative për periudhën e raportuar 2013-2015.

Shpenzimet operative -KOSTT	2013		2014		2015		2013-2015		Realizimi %
	Lejuar	Realizimi	Lejuar	Realizimi	Lejuar	Realizimi	Lejuar	Realizimi	
	('000) €	('000) €	('000) €	('000) €	('000) €	('000) €	('000) €	('000) €	
Riparimi dhe Mirëmbajtja	1,617	1,050	1,564	813	1,499	612	4,680	2,475	53%
Shp. e stafit	3,745	4,458	3,660	5,014	3,532	5,103	10,937	14,575	133%
Shp. tjera operative	1,860	1,862	1,865	1,790	1,853	1,719	5,579	5,371	96%
Total shpenzimet operative	7,222	7,370	7,090	7,617	6,884	7,434	21,197	22,421	106%

Tabela 2- Kostot e operimeve dhe të mirëmbajtjes KOSTT

2.4 Të dhënat energjetike dhe financiare 2013-2015

Në tabelën në vijim është paraqitur energjia elektrike e prodhuar nga gjeneratorët vendor që ka hyrë në rrjetin e transmisionit dhe energjia elektrike e blerë për konsumatorët fundor nga Furnizuesi Publik.

Gjenerimi	2013 (MWh)	2014 (MWh)	2015 (MWh)	Total (MWh)
Kosova B (MWh)	3,863,439	3,349,065	3,582,170	10,794,674
Kosova A (MWh)	2,014,046	1,508,885	1,905,371	5,428,302
HC Ujmani (MWh)	99,387	101,517	103,305	304,209
HC Lumbardhi (MWh)	29,707	31,679	23,266	84,652
Energjia për FPEE (MWh)	5,524,448	5,355,579	5,552,847	16,432,874

Tabela 43-Të dhënat në MWh 2013-2015 KOSTT

Shënim: Në kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes në tabelen 3 nuk janë përfshirë shpenzimet për blerjen e humbjeve dhe kostot e ndërlidhura me investimet kapitale (zhvlerësimi dhe kthimi i lejuar).



Në vijim janë paraqitur të hyrat e KOSTT-it nga të licencuarit për periudhën 2013-2015.

Të hyrat sipas te licencuarve	2013 (‘000) €	2014 (‘000) €	2015 (‘000) €	Total (‘000) €
Të hyrat nga KESCO	14,576	16,362	19,352	50,291
Të hyrat nga G (Kosova B)	1,940	1,669	2,815	6,424
Të hyrat nga G (Kosova A)	1,014	748	1,605	3,368
Te hyrat nga HC Ujman dhe gjener.tjere	49	51	82	182
Total	17,579	18,831	23,854	60,264

Tabela 54-Të dhënat financiare 2013-2015 KOSTT

Të hyrat e KOSTT sipas aktiviteteve të licencuara për periudhën 2013-2015 janë paraqitur në tabelën në vijim.

Të hyrat sipas aktiviteteve	2013 (‘000) €	2014 (‘000) €	2015 (‘000) €	Total (‘000) €
Të hyrat nga TNUOS	11,879	13,843	15,226	40,948
Të hyrat nga OS	5,395	4,698	8,294	18,388
Të hyrat nga OT	305	289	334	929
Total	17,579	18,831	23,854	60,264

Tabela 65-Të hyrat sipas aktiviteve të KOSTT

Nga tabelat e mësipërme vërehet se përgjatë viteve sipasojë e rritjes së rrjedhave të energjisë në rrjetin transmetues janë rritur edhe të hyrat për KOSTT.

2.5 Piku maksimal - profili i ngarkesës

Funksionimi i sigurt i rrjetit të transmisionit mund të vlerësohet me kapacitetin transmetues të tij. Për analizën e pikut të sistemit merren pesë (5) ngarkesat maksimale të realizuara në javë të ndryshme të vitit të cilat janë paraqitur në tabelën në vijim.

Piku maksimal	Njesia	2013	2014	2015
Piku 400/220 kV	MW	53	80	50
Piku 110 kV	MW	1,048	1,074	1,079
Piku maksimal	MW	1,101	1,154	1,129

Tabela 76-Piku në sistem 2013-2015

Vlerat e pikut lexohen në javë të ndryshme gjatë vitit, ku ngarkesa më e lartë në sistemin elektroenergjetikë të Kosovës është regjistruar në vitin 2014 në vlerë prej 1,154 MW. Konsumi pëson ndryshim në periudha ditore dhe sezonale, dhe përcjellja e këtyre ndryshimeve shkakton probleme për balancimin e sistemit. Pra, brenda të njëjtës ditë në orët e ditës (tarifa e lart) prodhimi nuk e mbulon kërkesën dhe nevojitet të importohet energji elektrike, ndërsa gjatë natës (tarifa e ulët) ka teprica të energjisë të cilat duhet të eksportohen.



2.6 Humbjet në nivelin e transmisionit

Humbjet në rrjetin e transmisionit të Kosovës janë përafërsisht në të njëjtin nivel me humbjet në sistemet transmetuese në rajon dhe Evropë, madje më mirë se disa nga shtetet e rajonit. Përveç investimeve kjo arsyetohet edhe për faktin se distanca e linjave që lidhë konsumin me prodhimin në Kosovë është relativisht e shkurtër, që ndikon në humbjeve më të ulëta gjatë bartjes së energjisë elektrike.

Niveli i lejuar i humbjeve në transmision për periudhën 2013-2015 është 1.80% e energjisë së transmetuar për qëllime të konsumit të konsumatorëve dhe eksportit.

KOSTT Sh.A ka realizuar humbjet më ulëta në raport me caqet e përcaktuara nga ZRRE në shqyrtimin Shumë-Vjeçare tarifor, siç është paraqitur në tabelën në vijim.

Humbjet ne transmision	Njësia	2013	2014	2015
Lejuar	€000	3,360	3,269	3,021
Realizuar	€000	3,339	3,063	3,076
Lejuar	%	1.80%	1.80%	1.80%
Realizuar	%	1.70%	1.84%	1.77%
Lejuar	GWh	111	112	111
Realizuar	GWh	110	109	110

Tabela 8-Humbjet e lejuara dhe të realizuara 2013-2015 KOSTT

2.7 Shërbimet ndihmëse dhe Mekanizmi i ITC

Me qëllim të operimit stabil dhe të besueshëm të sistemit elektroenergjetik, KOSTT është i obliguar të sigurojë shërbimet e nevojshme ndihmëse për sistemin elektroenergjetik. Në shërbimet ndihmëse përfshihen shërbimet për sigurimin e rezervës sekondare dhe terciare.

Në të Hyrat e KOSTT-it për vitin 2015 janë përfshirë edhe të hyrat prej 3.9 mil € për kostot e parashikuara të shërbimeve ndihmëse. Gjatë vitit 2015 nuk ka ndodhur shpenzimi d.m.th. këto kosto nuk janë realizuar dhe ZRRE gjatë azhurnimeve vjetore i ka zbritur nga të hyrat e lejuara këto shpenzime të pa realizuara.

Arsyeja e mosrealizimit të këtyre kostove është pamundësia e KOSTT-it që të fillojë të operoj si zonë rregulluese. Sipas marrëveshjeve me ENTSO-E, KOSTT është dashur të fillojë të operoj si zonë rregulluese nga muaji Qershor 2015, por për shkak të obstrukcioneve të bëra nga EMS dhe ndikimi politik i Serbisë ka ndodhur shtyrja e fillimit të operimit të KOSTT si zone rregulluese.

Realizimi i këtyre kostove ka qenë jashtë kompetencave dhe faktorëve ndikues të KOSTT andaj edhe përgjegjësia nuk bie mbi kompaninë.



KOSTT sh.a nga data 1 janar 2016 është pjesë e ITC mekanizmit, ku është informuar nga ENTSO-E. KOSTT duke qenë pjesë e këtijë mekanizimi do të paguaj/kompenzohet për fondin e ITC për NEF (net eksport flow) dhe NIF (net import Flow) dhe kompensimin që KOSTT duhet të marrë për transitin e energjisë elektrike në rrjetin transmetues horizontal.